



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr.23, datë 26.07.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**

**“NDËRTIMI I HEC “THANZA”, NË UJRAT E PËRROIT TË KALIMASHIT, I CILI  
DERDHET NË LIQENIN E FIERZËS, BASHKIA KUKËS, QARKU KUKËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Hec “Thanza”, në ujrat e përroit të Kalimashit, i cili derdhet në Liqenin e Fierzës, Bashkia Kukës, Qarku Kukës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Afrimi K” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Kukës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIA TOTA